

## Rrjeti për Ruajtjen e Cetaceve dhe Breshkave Detare në Adriatik

Projekti NETCET financohet nga Programi IPA Adriatik CBC dhe përfshihet në Prioritetin 2 “Burimet Natyrore dhe Kulturore dhe Parandalimi i Rreziqeve”.

Qëllimi kryesor i këtij programi bashkëpunimi ndërkuftar është forcimi i kapaciteteve për një zhvillim të qëndrueshëm të rajonit të Adriatikut, nëpërmjet një strategjie të përbashkët aktivitetesh midis vendeve partnere të këtij rajoni.

Faqja ëeb e projektit: [www.adriaticpacbc.org](http://www.adriaticpacbc.org)

### PËRMBAJTJA

*Ku janë duke shkuar breshkat tona?*

*Qendra e Ndhmës së Shpejtë për Breshkat Detare në Bregdetin Venecian*

*Ruajta e përbashkët strategjike e Cetaceve dhe Breshkave të Detit*

*Ngecje masive e kashalotëve në bregdet në Vasto (Itali)*

*Zona e mbrojtur për rehabilitimin e Breshkave të Detit në Numana (Itali)*

## 1. Ku janë duke shkuar breshkat tona: gjurmimi satelitor i breshkave detare në Detin Adriatik



Breshkat tona janë duke transmetuar! Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që ato

janë duke lëvizur nëpër Detin Adriatik, ndërkohë që transmetuesit satelitorë mbi to

janë duke treguar vendndodhjen e tyre në intervale kohe të rregullta, së bashku me të dhëna të tjera interesante dhe të rëndësishme. Por le ta nisim nga fillimi: Sikurse mund t'ju kujtohet, një aktivitet i veçantë i projektit NETCET ka të bëjë me gjurmimin satelitor të breshkave detare në Adriatik. Ky aktivitet koordinohet nga studiues të Universitetit të Primorska, Slloveni. Transmetuesit satelitorë janë pajisje të vogla të cilat mund t'u vendosen kafshëve, siç janë edhe breshkat detare. Më pas ata transmetojnë informacion mbi vendndodhjen e breshkave nëpërmjet

satelitëve që rrotullohen rreth Tokës. Këto transmetues mund të japin informacion shumë të rëndësishëm, i cili nuk mund të merret në mënyra të tjera.

Pjesa veriore e Detit Adriatik është njohur tashmë si një vend i rëndësishëm për ushqim për breshkën e detit *Caretta caretta*, në veçanti për juvenilet. Dihet gjithashtu se 95% e këtyre breshkave vijnë nga popullata folezuese në Greqi, ndërsa pjesa tjetër vjen nga Turqia, Qipro dhe Libia. Dihet se kur temperaturat ulen në dimër, breshkat duhet të ikin diku tjetër, pasi ato nuk mund të mbijetojnë në ujra kaq të ftohta. Por ajo çfarë ne nuk dimë është se ku shkojnë këto breshka gjatë dimrit të ftohtë, as ku e kalojnë kohën gjatë fazës së tyre juvenile dhe nëse ato kthehen në të njëjtat vende ku ushqehen në pranverë.

Projekti NETCET është i interesuar veçanërisht të dijë cilat zona janë habitate të rëndësishme për dimërimin, cilat janë rrugët kryesore për migrim dhe nëse i njëjti individ kthehet në të njëjtat vende vit pas viti. Këto pyetje janë të rëndësishme për të përgatitur strategji të duhura për ruajtjen e këtyre kafshëve, për të cilat punon projekti NETCET. Për

këto arsye, gjatë verës së vitit 2014, ne shpenzuam shumë kohë duke punuar me breshkat. Peshkatarët shpesh i kapin ato në rrjetat e tyre dhe shumë breshka janë ende gjallë kur peshkatarët i tërheqin ato në varkat e tyre. Ne u kërkuam peshkatarëve në Slloveni dhe Kroaci të sillnin çdo breshkë të kapur tek ne. Në sajë të bashkëpunimit të tyre, mjaft breshka u sollën tek ne. Disa prej tyre ishin shumë të mëdha, disa shumë të vogla për pyetjet tona të veçanta. Megjithatë, një pjesë e mirë e tyre ishin të masës së duhur, që do të thotë se ato ishin ende juvenile (për të cilët ne na duhet ky informacion), por mjaftueshëm të mëdha që transmetuesi satelitor të mos ishte shqetësues për ato. Të gjitha breshkat u sollën fillimisht në qendrat e rehabilitimit në Piran (Slloveni) dhe Pula (Kroaci), për të vlerësuar shëndetin e tyre dhe për t'u siguruar që ato nuk ishin të dëmtuara. Më pas, ne i pajisëm këto breshka me transmetues satelitorë të veçantë që mblidhin informacion mbi vendndodhjen, kohën, të dhëna mbi zhytjen dhe thellësinë, si dhe temperaturën e ujit. Transmetuesit kanë

formë hidrodinamike, kështu që ato nuk paraqesin vështirësi për lëvizjen e breshkave, nuk i pengojnë ato për të notuar apo për t'u zhytur normalisht. Ne fillimisht testuam transmetuesit dhe aftësinë notuese të breshkave në një mjedis të kontrolluar përpara se t'i lëshonim në det. Gjatë procesit, na u desh të bënim disa rregullime në konfigurimet e transmetuesve për të rritur efektshërinë e tyre. Të gjitha breshkat u duk se sillleshin normalisht dhe transmetuesit dukej se nuk i shqetësonin ato aspak. Të gjitha sjelljet e të notuarit, zhytjes dhe të të ushqyerit dukeshin normale.

Në Tetor 2014, ne lëshuam 6 breshka *Caretta caretta* nga Sllovenia dhe 4 nga Kroacia. Shumica e këtyre breshkave qëndruan në të njëjtën hapësirë të përgjithshme ku ato ishin kapur më parë, por më pas ato filluan të lëviznin drejt Jugut në fund të Nëntorit, duke qenë se temperaturat e ujit filluan të ulen. Megjithatë, pyetja më e rëndësishme dhe interesante do të ishte çfarë ndodhi në muajt në vazhdim. Ju mund të ndiqni lëvizjet e këtyre breshkave në linkun që vijon:

[http://ëëë.seaturtle.org/trackin/g/?project\\_id=1021](http://ëëë.seaturtle.org/trackin/g/?project_id=1021)

Krahas breshkave të llojit *Caretta caretta* në Adriatikon e Veriut, u janë vendosur gjithashtu transmetues satelitorë 3 breshkave të gjelbra (*Chelonia mydas*) në Shqipëri dhe Mal të Zi. Disa prej tyre janë tashmë përgjatë bregut Libian. Gjatë dimrit 2014-2015, do t'u vendoset transmetues edhe 10 breshkave të tjera.

Tilen Genov – Universiteti i Primoska



## 2. Qendra e parë e Ndhmës së Shpejtë për breshkat detare në Bregdetin Venecian është gati!



Punimet për Qendrën e Ndhmës së Shpejtë të Qytetit të Venecias për breshkat e detit, të financuar nga projekti NETCET, u mbyllën në Tetor 2014. Kjo qendër për trajtimin e emergjencave është strehuar me dashamirësi brenda Qendrës Residenciale “F. Morosini”, një kompleks strehuar veror për të moshuar dhe fëmijë, të drejtuar nga Institucioni Bashkiak i Qendrave të Residencës, në ishullin Lido të Venecias, midis Malamocco dhe Alberoni.

Është një strukturë e vogël e projektuar për t'u siguruar ndihmën e shpejtë breshkave detare të gjetura të ngecura në brigje ose në vështirësi përgjatë bregdetit Venecian dhe në lagunë (por gjithashtu edhe në pjesë të tjera të bregut Venecian, nëse është e nevojshme). Është menduar fillimisht për tu siguruar mbështetje logjistike atyre grupeve të cilat kanë qenë tashmë duke punuar në zonë prej disa vitesh mbi ruajtjen e këtyre specieve, fillimisht “Coordinamento Tartarughe marine del Litorale Veneto” (CTLV, rrjeti Venecian i shpëtimit të breshkave detare),


Roja Bregdetare dhe Policia Pyjore. Qendra do të bashkë-menaxhohet nga Muzeu i Historisë Natyrore dhe Bashkia e Venecias, me mbështetjen e veterinerëve të kualifikuar dhe vullnetarëve të CTLV.

Kafshët që sillen në Qendër do të vizitohen menjëherë nga një veteriner i cili, nëse është e nevojshme, do t'u sigurojë atyre ndihmën e shpejtë, përpara sesa ato të transferohen (brenda 48 orësh) në një strukturë të kualifikuar për një përkujdesje më të specializuar, apo ato të lëshohen në det nëse janë në gjendje të shëndetshme.

Qendra përbëhet nga një zyrë, një laborator i vogël biologjik-veterinar dhe një zonë e jashtme me tre vaska me diametër ndërmjet 150 dhe 200 cm, të mbrojtura nga një çati prej druri. Vaskat janë të lidhura me një qark të mbyllur uji, të pajisur me filtrues dhe sterilizues UV dhe të furnizuara me ujë deti artificial (por ato mund të përdorin gjithashtu ujë nga laguna).

Brenda zonës ka gjithashtu hapësira të gjera të brendshme të cilat do të përdoren, në marrëveshje me institucionin strehuar, për aktivitete informuese dhe educative, ndërsa plazhi aty pranë do të jetë skena e aktiviteteve me pjesëmarrjen e publikut për rritjen e ndërgjegjësimit mbi ruajtjen e breshkave të detit.

Në mes të Tetorit 2014, për të shënuar fundin e punimeve, është organizuar një aktivitet i vogël, me pjesëmarrjen e profesionistëve dhe fëmijëve të shkollave, duke bërë edhe rikthimin në det të një breshke *Caretta caretta* të re, e quajtur “Luna” (“Hëna” – në shqip), e shpëtuar verën e kaluar nga CTLV, pasi u gjet e ngecur në breg në ishullin Pellestrina. Qendra është tani në pushim gjatë dimrit dhe hapja zyrtare e qendrës është planifikuar në pranverën e vitit 2015.



Muzeu Venecian i Historisë Natyrore




### 3. Instrumentat për një strategji afatgjatë të përbashkët për ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare në Adriatik

Instituti Kombëtar Italian për Mbrojtjen dhe Studimin e Mjedisit (ISPRA) dhe Instituti Shtetëror Kroat për Mbrojtjen e Natyrës (SINP) koordinuan aktivitetin ndër-sektorial të projektit NETCET për të përcaktuar "Instrumentat për një strategji të përbashkët afatgjatë për ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare në Adriatik".

Objektivat kryesorë janë:

- ❖ të përcaktojnë strategji të përbashkëta për ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare në Detin Adriatik, të bazuar mbi njohuritë më të fundit mbi cetacetë dhe breshkat detare, të kërcënimeve ekzistuese dhe direktivave ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare;
- ❖ të mbështetin me efektivitet hartimin apo përditësimin e Planeve të Kombëtare Veprimit (PKV) për këto specie.

Përgatitja e materialit ad hoc, në formën e disa dokumentave, do të ndihmojë duke formuluar veprimet e nevojshme dhe masat për të siguruar ruajtjen afatgjatë të cetaceve dhe breshkave të detit në Detin Adriatik, duke u bazuar mbi direktiva ekzistuese ndërkombëtare ose kombëtare që janë në fuqi. Strategjia e përbashkët për ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare do të përqëndrohet në një plan prej 5 vitesh pas përfundimit të projektit. Këto qëllime do të arrihen nëpërmjet një numri të madh masash dhe aktiviteteve.



Aktiviteti i parë (i përfunduar) është një rishikim fillestar i gjendjes më të fundit të cetacevë dhe breshkave detare, duke përfshirë shqyrtimin e gjendjes së popullatave (p.sh. dendësinë dhe shpërndarjen e tyre) dhe rreziqet që mund të çenojnë këto popullatat në Detin Adriatik. Për më tepër, ai përfshin shqyrtimin e direktivave ligjore, institucionale, kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me ruajtjen e këtyre specieve, si edhe nisma dhe aktivitete ekzistuese të lidhura me to.

Duke u bazuar në analizime të mëparshme, do të identifikohen masat për ruajtjen dhe zvogëlimin e impakteve negative të aktiviteteve njerëzore mbi cetacetë dhe breshkat e detit në Adriatik. Për shembull, do të propozohen masa për të zbutur vdeshmërinë aksidentale të shkaktuar nga mjetet e peshkimit, ose shqetësimin e shkaktuar nga zhurma antropogjene e prodhuar gjatë aktiviteteve të veçanta, siç janë kërkimet në det për gaz dhe naftë, si dhe gjatë shfrytëzimit të tyre.

Një veprim tjetër thelbësor i këtij aktiviteti është përcaktimi i strategjive të përbashkëta për ruajtjen e cetaceve dhe breshkave të detit në Detin Adriatik. Kjo duhet bërë përmes një këshillimi të gjerë, me të gjithë partnerët e projektit, autoritetet përkatëse dhe pjestarët e rrjetit NETCET mbi atë çfarë realisht mund të organizohet dhe koordinohet në nivelin e basenit të Adriatikut, në aspektin e menaxhimit të aktiviteteve njerëzore që kanë impakt mbi popullatat e cetaceve dhe breshkave të detit. Ky aktivitet do të thjeshtohet mjaft edhe nga vëzhgimi i dokumentacionit ekzistues (gjendja më e fundit) dhe nga masat e propozuara për ruajtjen, të përshkruara më përpara në paketën përkatëse të punës. Aktiviteti do të përfshijë gjithashtu edhe këshillime me organizma ndërkombëtare, siç janë Marrëveshja mbi Ruajtjen e Cetaceve në Detin e Zi, Detin Mesdhe dhe Zonën Atlantike të Afërt (ACCOBAMS), Qendra Rajonale e Aktiviteteve për Zonat e Mbrojtura të Veçanta (RAC/SPA), Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (GFCM), Adriamed, Departamenti i Detit dhe Departamenti i Mjedisit i Komisionit Europian.

Në fund, e gjithë puna e zhvilluar do të mundësojë hartimin apo përditësimin e Planit Kombëtar të Veprimit mbi ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare në të gjithë vendet a Adriatikut (Shqipëria, Mali i Zi, Bosnia dhe Hercegovina, Kroacia, Sllovenia dhe Italia), nëpërmjet këshillimit me palët e interesuara dhe autoritetet kombëtare dhe rajonale përkatëse. Këto plane do të prezantohen në konferencën përfundimtare të NETCET në Dhjetor 2015.

Caterina Fortuna – Instituti Kombëtar Italian për Mbrojtjen dhe Studimin e Mjedisit  
Ana Maričević – Instituti Shtetëror Kroat për Mbrojtjen e Natyrës

## 4. Ngecje masive të kashalotëve në bregdet në Vasto (CH): një përditësim



Ngecjet masive të kashalotëve në bregdet janë ngjarje e rrallë në Detin Mesdhe, megjithatë Adriatiku duket të jetë një kurth për këto specie. Që prej vitit 1555, në brigjet e Adriatikut njihen 8 ngecje tufash me individë të kësaj specie. Më e fundit ka ndodhur në Shtator 2014, ku përfshiheshin 7 femra adulte. Në këtë rast, u bë e mundur ndërhyrja e një Task Force, e koordinuar nga Grupi i Ndërhyrjes për Emergjencat e Cetaceve të Ngecura në brigje, nga Universiteti i Padovas. Ky grup mundi të kryente analiza autopsie, për të kuptuar shkaqet e këtyre ngjarjeve, siç ka ndodhur edhe në Dhjetor 2009, kur 7 meshkuj të rinj ngecën në brigjet e Garganos.

Këtë herë, bashkëpunimi ndërmjet disa institucioneve, shumica prej tyre brenda rrjetit shkencor të përfshirë në projektin NETCET, lejoi një veprim të suksesshëm: më hollësisht, rojet e bregdetit dhe rrjeti lokal i vëzhgimit të ngecjeve të cetaceve në brigje, i koordinuar nga Qendra e Studimit të Cetaceve, Bashkia e Peskarës, partnere e Projektit NETCET, ishin të aftë të rikthenin në det 4 prej 7 individëve. Ky ishte një rezultat i papritur, meqenëse zakonisht, vdekja duket se është i vetmi fat për balenat e ngecura në brigje. Përgjigjja e menjëhershme e rrjeteve kombëtare dhe lokale ishte gjithashtu e mundur në sajë të komunikimit që Instituti Bota Blu (Koraci) bëri për praninë e një tufe kashalotësh në Adriatik.

Sandro Mazzariol – Universiteti i Padovas

U zhvilluan autopsi mbi tre balenat e ngordhura nga më shumë se 50 veterinerë, shumica e të cilëve kanë qenë pjesëmarrës në trainime të zhvilluara nga Universiteti i Padovas, në kuadër të projektit NETCET. Megjithëse analizat janë ende duke u kryer, rezultatet e para treguan përfundime interesante. Në veçanti, falë mbështetjes së shkencëtarëve nga Ishujt Kanarie (Prof. Antonio Fernandez) dhe nga Kanada (Dr. Maria Morrell) u përjashtua mundësia e embolisë nga gazi dhe yndyra. Aktivitetet detare që përdorin burime të zhurmave (p.sh. aktivitete ushtarake dhe vëzhgime sizmike), të cilat janë shkak kryesor për ngecjet masive të balenave në brigje, mendohet se nuk kanë shkak për rastin e sipërpërmendur, pasi nuk rezultoi të ketë patur aktivitete të tilla në atë periudhë.

Në të vërtetë, shkaqe të tjera duket se janë më domethënëse për ngjarjen e sipërpërmendur. Më hollësisht, të gjitha femrat ishin duke vuajtur nga një periudhë e gjatë pa ushqim dhe më e madhja ishte shtatzënë dhe me shenja të dëmtimeve të veshkave. Analizat molekulare dhe imuno-histokimike treguan gjithashtu shenja infeksioni nga Morbillivirus, por jo në shkallë të rëndë. Këto gjetje, së bashku me aspekte sociale dhe të sjelljes së kashalotëve do të trajtohen si një nga aspektet më të rëndësishme në përcaktimin e ngecjes në brigje.

## 5. Zona e mbrojtur për rehabilitimin e breshkave të detit në Numana (IT)

Qershorin e kaluar, për herë të dytë gjatë zbatimit të projektit NETCET, Fondacioni Cetacea ngriti një zonë të mbrojtur për rehabilitimin e breshkave të detit në ujrat e Numana (Itali). Për shkak të kushteve të papërshtatëshme të detit, që shpesh nuk lejuan të punohet nën ujë, zëvendësimi i rrethimit (gardhit) ka qenë shumë i vështirë por në fund u realizua. Këtë vit zona e rrethuar ishte 1200 m<sup>2</sup> dhe ishte e mbrojtur nga dy gardhe, një mbrojtje e jashtme nga algat dhe nga kureshtarët dhe një e brendshme, gardhi i vërtetë, me rrjetë të fortë me syza 4 cm. Megjithatë, lajmi nuk ka të bëjë shumë me përmirësimin e zonës së rrethuar në Numana, por më shumë në suksesin publik të pabesueshëm të kësaj zone.



Bashkia e Numanas nisi një projekt të titulluar “Qyteti Numana për Breshkat” dhe e bëri këtë titull si një logo që i shfaqej turistëve dhe vendasve. Rezultati ishte i mrekullueshëm! Gjiri i vogël i breshkave të detit tërhoqi një përqindje të lartë të turistëve në Numana (20%). Çdo ditë shumë njerëz grumbulloheshin përpara zonës së para-lëshimit për të kërkuar informacion ose për të marrë pjesë në takime të planifikuara me biologët e Fondacionit Cetacea. Të tetë aktivitetet e lëshimit patën një pjesëmarrje të lartë (afërsisht 3,000 pjesëmarrës).

Për më tepër, përdorimi i gjirit për qëllime shkencore u rrit: si shtesë ndaj monitorimit të zakonshëm të kafshëve, nën projektin Tartalife dhe në bashkëpunim me CNR të Ankonas, u testua një sistem (i quajtur STAR) për të shmangur kapjet jo të qëllimshme të breshkave detare me grepa. Kushtet e motit të keq kufizuan provat në një javë, por ne jemi tashmë duke programuar një provë të re për verën e ardhshme. Suksesi i zonës së gardhuar ishte kaq i rëndësishëm për Bashkinë e Numanas, sa që ajo ka kërkuar tanimë ta përsërisë atë në 2015.

*Sauro Pari – Fondacioni Cetacea*

## NJOFTIME

### **Takimi i radhës midis partnerëve të projektit në Pola (Kroac): Mars 2015**

Takimi i radhës i partnerëve të projektit do të mbahet në Pula, Kroaci, më 10 – 11 Mars 2015, i organizuar nga Qendra e Edukimit Detar. Takimi do të jetë i rëndësishëm për partnerët e NETCET për të vlerësuar rezultatet e arritura deri tani dhe për të planifikuar hapat e mëtejshme për të realizuar qëllimet e projektit.



### **Konferenca Përfundimtare e projektit NETCET: Dhjetor 2015**



Projekti NETCET do të mbajë konferencën e tij përfundimtare në 3 - 4 Dhjetor 2015 në Venecia (Itali). Konferenca përfundimtare do të prezantojë rezultatet e projektit, por do të jetë gjithashtu një rast shumë i mirë për të ndarë përvojat dhe njohuritë mes ekspertëve dhe politikëbërësve në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe European.

### **Rrjeti i Qyteteve NETCET: përditësim**

Rrjeti i Qyteteve NETCET, i përbërë nga qytete të cilat marrin përsipër të informojnë publikun rreth rreziqeve për breshkat detare dhe cetacetë dhe të reduktojnë impaktet ndaj këtyre kafshëve detare, është duke u rritur! Deri më sot, 20 qytete kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit: Mali Losinj, Pula, Zadar dhe Dubrovnik nga Kroacia; Kotor, Budva dhe Tivat nga Mali i Zi, Vlora dhe Patok- Fushe Kuqe nga Shqipëria, Manfredonia, Pescara, Numana, San Benedetto del Tronto, Chioggia, Brindisi, Jesolo, Fano, Grado dhe Venezia nga Italia.



The project is co-funded by the European Union,  
Instrument for Pre-Accession Assistance.



## Contact

City of Venice

[info@netcet.eu](mailto:info@netcet.eu)

Economic Development, European  
Policies and Strategic Plan Division

+39 041 2747826 / 7830 / 7834

San Marco 4299  
30124 Venice - Italy

[www.netcet.eu](http://www.netcet.eu)

[www.facebook.com/NETCETproject](https://www.facebook.com/NETCETproject)

This Newsletter has been produced with the financial assistance of the IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme. The contents of this Newsletter are the sole responsibility of the City of Venice and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme Authorities.